DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU

ASC- 10-0016

Në padinë e

Paditësit/Ankuesit

F.L, R.P, Xh.L, B.GJ, Xh.L,
M.G, N.L, Z.B, N.L, A.L, A.V, A.L, B.L, L.L, L.
B, R.L, M.K, B.K, M.L, B.E, N.J, Xh. L, N. H dhe N.K,
Të përfaqësuar nga A.V, avokat nga Mitrovica dhe H. H, avokat nga Prishtina

Kundër

Të paditurat

1. **Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM)**
2. **Hotel "M", Ndërmarrje Shoqërore, Pejë,**
   përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr. sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj, Gertraud Marx-Leitenberger, Ondrej Pridal dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur në ankesën e parashtruar kundër Aktgjykimit të DHPGJS-së të datës 10 Dhjetor 2009, SCC-05-0453, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 2 shtator 2016, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. **Ankesa e parashtruar nga paditësit refuzohet si e pabazuar..**

2. **Vërtetohet Aktgjykimi i Trupit Gjykues të DHPGJS-së, SCC-05-0453, i datës 10 dhjetor 2009.**

3. **Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën e ankesave.**

Rrethanat procedurale

Më 11 tetor 2008, paditësit dorëzuan në Dhomën e Posaçme një padi për vërtetimin e pronësisë së “H. K” në Pejë, një ndërtesë katërkatëshe e ndërtuar fillimisht në vitin 1929, dhe një kërkesë për masë të përkohshme.

Është e pakontestueshme që paraardhësit e paditësit, Y dhe S.L, e kishin blerë “H. K” nga A.M në vitin 1941. Transaksioni ishte regjistruar në kohën dhe mënyrën e duhur.

Me aktvendimin K.K. nr. 18/45 të datës 29 dhjetor 1945, Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi “t’ua konfiskojë pronën e paluajtshme të armiqve të popullit dhe të arratisurve nga autoritetet popullore për në Shqipëri, Y dhe S.L” në bazë të Ligjit për Konfiskimin e Pronës dhe Ekzekutimin e Konfiskimit (Gazeta Zyrtare e Federatës Demokratike të Jugosllavisë NR. 40/45 e datës 9 qershor 1945). Në këtë aktvendim përfshihej “H. K".

Më 28 prill 1960, Kuvendi Komunal i Pejës ia ndau Hotelin e kontestuar Kompanisë Hoteliere “M”.

Më 3 gusht 1999, paditësit kërkuan nga Komuna e Pejës posedimin e pronës kontestuese duke e shpallur veten si pronarë. Më vonë, me gjasë me vendim të Kuvendit Komunal të Pejës paditësit e fituan posedimin e kërkuar.

Në korrik të vitit 2000, paditësit nisën procedurë në Gjykatën Komunale të Pejës për rishikimin e aktvendimit nr. K.K. Nr. 18/45. Gjykata Komunale e Pejës e hodhi poshtë kërkesën me aktvendimin nr. 29/00 të datës 17 shkurt 2004. Hedhja poshtë ishte bazuar në mungesën e juridiksionit. Më 15 mars 2004, paditësit parashtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Gjykata e Qarkut në Pejë e miratoi ankesën dhe e udhëzoi Gjykatën Komunale që të vendosë në meritat e kërkesës (PN 329/04, datë 24 dhjetor 2004). Pas rigjykimit, gjykata komunale sërish e refuzoi kërkesën e paditësve me aktvendimin e datës 23 maj 2006. Ankesa e paditësve kundër këtij aktvendimi nuk pati sukses. Me aktvendimin Pn.Nr. 74/06 të datës 10 janar 2007, Gjykata e Qarkut në Pejë e refuzoi ankesën dhe e vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Komunale të datës 23 maj 2006. Më 9 mars 2007, përfaqësuesi ligjor i paditësve parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme të Prishtinës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke e kundërshtuar aktvendimin KP Nr. 5/05 të Gjykatës Komunale dhe aktvendimin Pn.Nr. 74/06 të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Në ndërkohë, paditësit e shpallën vetën si pronarë të pronës kontestuese para AKM-së, AKM-ja ua kishte miratuar paditësve posedimin e përkohshëm. Paditësit kishin bërë disa renovime dhe kishin hapur pjesërisht Hotelin. Më vonë, më 14 korrik 2003, Zyra Rajonale e AKM-së në Pejë e vërtetoi se paditësit ia kishin dorëzuar AKM-së çelësat e pronës kontestuese. Më 19 shtator 2003, Bordi i AKM-së vendosi që prona kontestuese është pronë shoqërorë. Më pastaj, AKM-ja e përfshiu pronën kontestuese në valën 8 të privatizimit në vitin 2005 dhe i udhëzoi paditësit që të parashtrojnë padinë e tyre në Dhomën e Posaçme.

Sipas kërkesës dhe padisë së paditësve të datës 11 tetor 2005, Dhoma e Posaçme me aktvendimin e datës 12 tetor 2005 e miratoi masën e përkohshme dhe ia ndaloi AKM-së për 3 muaj vazhdimin e procesit të privatizimit me kusht që paditësit të deponojnë në gjykatë një shumë prej 20,000 Euro si garanci.

Më 7 nëntor 2005 dhe 25 nëntor 2005, paditësit e ndryshuan padinë e tyre dhe i ofruan Gjykatës dokumente plotësuese (të dhënat kadastrale dhe shpenzimet e renovimeve). Në radhë të parë ata kërkonin pronësinë dhe posedimin e pronës kontestuese dhe si alternativë kërkonin që të shpallet i paligjshëm vendimi i Bordit të AKM-së me të cilin prona kontestuese ishte shpallur pronë shoqërore, t'i ndalohet AKM-së privatizimi i pronës dhe të urdhërohet AKM-ja që t'ua kthejë në posedim të paditësve.

Më 29 nëntor 2005, AKM-ja e dorëzoi mbrojtjen dhe kundërpadinë e saj. AKM kërkoi hedhjen poshtë të padisë mbi bazën se ishte e paafatshme si dhe në merita mbi bazën se nuk ka vendim gjyqësor që tregon se konfiskimi ishte i paligjshëm. Duke ju referuar padisë shtesë të paditësve lidhur me renovimet, AKM-ja theksoi se ajo kurrë nuk ka dhënë pëlqim për ndonjë punë shtesë të kryer nga paditësit. Me kundërpadi AKM-ja kërkoi: 915,000 Euro kompensim për humbjet financiare të shkaktuara nga kontesti, 54,888 Euro për riparime të financuara nga AKM-ja; të gjithat tatimet në pronë që i kishte paguar NSH-ja për pronën kontestueses dhe shpenzimet gjyqësore.

Më 20 dhjetor 2005, paditësit dorëzuan përgjigjen e tyre me të cilën kërkuan që të përfshihet në padi NSH "M". Sa i përket kundërpadisë, paditësit i përsëritën argumentet e mësipërme lidhur me pronësinë dhe i propozuan Dhomës së Posaçme që ta hedhë poshtë atë si të pabazuar.

Më 9 janar 2009, paditësit paraqitën kërkesë për zgjatje të afatit të masës së përkohshme.

Dhoma e Posaçme mbajti seanca publike me 5 shtator 2006, 18 janar 2007 dhe 6 shkurt 2007. Palët njoftuan se Gjykata Komunale si dhe ajo e Qarkut në Pejë e kishin refuzuar kërkesën e paditësve për rishikimin e vendimit për konfiskimin. Paditësit njoftuan se kishin paraqitur kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Ndërkohë, më 5 shkurt 2007, paditësit e ndryshuan, zgjeruan dhe e përmblodhën padinë e tyre. Përveç padisë pronësore, ata, si alternativë, kërkuan 12,000 DM kompensim për investimet dhe 250,000 Euro për fitimin e humbur, e që të dyja këto në bazë të pasurimit të paligjshëm.

Më 31 korrik 2008, Dhoma e Posaçme e ndali procedurën derisa të vendosej mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Më 17 dhjetor 2008, Gjykata Supreme e Kosovës e refuzoi kërkesën e paditësve si të papranueshme. Gjykata Supreme theksoi se paditësit nuk kishin të drejtë të iniciojnë procedurë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Më 11 mars 2009, Dhoma e Posaçme e hoqi pezullimin dhe e njoftoi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për procesin ligjor në pritje. AKP-ja dhe UNMIK-u në emër të AKM-së e pranuan Aktvendimin e Gjykatës Supreme dhe propozuan hedhjen poshtë të menjëhershme të padisë.

Me parashtresën e tyre të dorëzuar më 1 qershor 2009, paditësit kërkuan pezullimin e procedurës në Dhomën e Posaçme derisa Gjykata Kushtetuese të lëshojë vendimin e saj. Ata gjithashtu e përmblodhën padinë e tyre përfundimtare ku kërkuan si më poshtë:

- të vërtetohen ata si pronarë të pronës kontestuese,
- të obligohet e paditura që ta dorëzojë posedimin,
- të kompensojë shpenzimet procedurale.

Si alternativë:

- të shfuqizohet vendimi i AKM-së lidhur me statusin e pronës shoqërore,
- të shfuqizohet privatizimi i pronës dhe
- të ndalohet AKM-ja në privatizimin e pronës.

Paditësit më tej kërkuan që:

- të shfuqizohet privatizimi i pronës.
- të shpallet i paligjshëm largimi i paditësve nga prona,
- të obligohet e paditura që ta dorëzojë posedimin dhe
- të ndalohet AKM-ja në privatizimin e pronës.

Paditësit nuk u deklaruan lidhur me masën e përkohshme.

Seanca dëgjimore e fundit u mbajt më 29 shtator 2009. Më 10 dhjetor 2009, trupi gjykues i DHPGJS-së lëshoi aktgjykimin ku vendosi si vijon:

1. E paditura e dytë në këtë lëndë emërtohet: Ndërmarrja Shoqërore Hotel "M", e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.
2. Refuzohet kërkesa për zgjatje të afatit të masës së përkohshme.
3. Shuma prej 20.000 (njëzet mijë) Euro të deponuara më parë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës si depozitim për zhdëmtim të Agjencisë për ndonjë dëmtim u kthehet paditësve.
4. Refuzohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit për pezullimin e kësaj procedure deri në përfundimin e procedurës që pret zgjidhje në Gjykatën Kushtetuese.
5. Padia pronësore e paditësve refuzohet si e pabazuar.
6. Ndërmarrja Shoqërore "M", e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit ua kompenson paditësve shumën prej 5 738, 74 (pesëmijeshtatëqindetridhjetetetë 74/100) Euro brenda një muaji nga aktgjykimi final.
7. Refuzohen kundërpaditë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
8. Secila palë i bartë vet shpenzimet procedurale.
9. Sipas nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankesa kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet në shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

Trupi Gjykues konsideron se aktgjykimi i vet nuk varej nga rezultatet e procedurës në pritje para Gjykatës Kushtetuese. Ai dha arsyetimin se pronën kontestuese ua kishin konfiskuar Y dhe S.L edhe pse nuk ishin themeluar kushtet që do të mundësonin konfiskimin dhe bartjen e pronës. Pasi që më 18 prill 1960 prona kontestuese ishte bartur nga Këshilli Popullor i Komunës së Pejës tek "ndërmarrja drejtuese hoteliere M për shfrytëzim dhe menaxhim" dhe të paktën që nga viti 1960 për 20 vite posedohej pa penguar (që prej kontestimit të parë gjendjes që ndodhi më 2 gusht 1999) nga Shteti përmes përfaqësuesit dhe menaxhuesit të tij, Trupi Gjykues konstatoi se e drejta pronësore e pronës kontestuese ishte bartur nga Shteti përmes parashkrimit fitues. Andaj,

kërkesat alternative të paditësve që kundërshtonin shpalljet e AKM-së lidhur me statusin e pronave si shoqërore dhe procedurat e privatizimit janë të pabazuara. Pasi që Trupi Gjykues e refuzoi padinë e paditësve, ai i refuzoi edhe kundërpaditë e parashtruara nga AKM-ja dhe AKP-ja si të pabazuara. Kërkesat e përsëritura të paditësve për zgjatje të afatit të masës së përkohshme (të lëshuar më 12 tetor 2005 me të cilën AKM-së iu ndalua vazhdimi i procesit të privatizimit i cili skadoi pas 3 muajve) u refuzuan si të pabazuara. Gjithashtu, pasi që masa e 12 tetorit 2005 nuk ishte më e vlefshme, Trupi Gjykues urdhëroi që shuma prej 20,000 Eurove, e deponuar më parë në DHPGJS si garanci për dëmet ndaj Agjencisë, tu kthehet paditësve. Trupi Gjykues vërtetoi se faturat e paraqitura nga paditësit dëshmojnë për shpenzimet e tyre për riparimet e hotelit nga viti 2001 – 2003 gjatë periudhës kur e udhëhoqën hotelin sipas lejes së Departamentit për Tregti dhe Industri (DTI) të UNMIK-ut. Trupi Gjykues arsyetoi se pasi që paditësit nuk kanë titull pronësie për "H.K", atyre duhet tu kthehet shuma që kanë paguar për renovimin e pasurisë së patundshme të paditurës; pra, padia e tyre për rimbursim në shumë prej 5 738.74 EUR është e bazuar.

Ky aktgjykim i ishte dërguar përfaqësuesit të paditësve, avokatit A.V, dhe AKP-së më 12 janar 2010; dhe më 14 janar 2010 Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut. Paditësit parashtruan ankesë më 10 shkurt 2010.

Paditësit (tani Ankuesit) pretendojnë shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimin e gabuar të të drejtës materiale. Ankuesit kërkojnë nga Kolegji i Apelit që ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke e miratuar padinë e tyre si të bazuar dhe t'i obligojë të paditurat që t'ua paguajnë shpenzimet procedurale bashkë me shpenzimet për përfaqësuesit e autorizuar të llogaritura sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës. Ankuesit e kundërshtojnë fuqishëm konkludimin e Trupit Gjykues se e paditura ka fituar pronësinë e pronës kontestuese përmes parashkrimit fitues. Ata pohojnë se paraardhësi ligjor i të paditurës nuk ka vepruar në mirëbesim kur e ka konfiskuar pronën e paraardhësve të ankuesve. Në kohën e Aktendimit për Konfiskim KK.nr.18/45 të datës 29 dhjetor 1945 Shteti në mënyrë të dhunshme u bë "*pronar*" i pronës së paluajtshme. Në anën tjetër, ata u pajtuan me mendimin e Trupit Gjykues se "*...kushtet e kërkuara për themelim të titullit të vlefshëm për lejimin e konfiskimit dhe bartjen e pronësisë nuk ishin plotësuar*". Ata insistojnë se mungon titulli i vlefshëm për bartjen e pronësisë e prandaj mungon edhe baza ligjore për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues.

Më 2 prill 2010, Kolegji i Apelit u njoftua se paditësja N.H vdiq më 13 janar 2010, dhe se procedurën e morën përsipër fëmijët/trashëgimtarët e saj Dh.H dhe Gj.C. Ata ofruan deklaratat me të cilat i pranojnë të gjitha veprimet e ndërmarra nga avokati A.V dhe gjithashtu e autorizuan atë që t'i përfaqësojë para Dhomës së Posaçme. Edhe trashëgimtarët e së ndjerës N.J, S. D dhe Sh.J, i dorëzuan deklaratat se i pranojnë të gjitha veprimet e ndërmarra deri tani nga avokati A. V që nga data e autorizimit më 14 tetor 2003 dhe se e autorizojnë atë që t'i përfaqësojë ata para Dhomës së Posaçme.

Më 15 tetor 2010, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (GJK) e refuzoi si të papranueshme Kërkesën e Ankuesve me të cilën e kundërshtuan Aktvndimin Nr.PKL.Nr. 21/07 të Gjykatës Supreme të datës 17 dhjetor 2008 për kërkesën e tyre për mbrojtje të ligjshmërisë.

Më 14 tetor 2011, AKP-ja e dorëzoi përgjigjen e saj në ankesën e ankuesve. Në përgjigje AKP-ja kërkoi nga DHPGJS-ja që të shikojë nëse ankesa është parashtruar në kohë sepse ankuesit nuk e kishin cekur në ankesën e tyre datën se kur e kishte pranuar aktgjykimin e ankimuar përfaqësuesi i tyre i autorizuar. Më tej ajo theksoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar. AKP-ja pohoi se ankuesit madje edhe në procedurën e ankesës nuk arritën ta bëjnë të besueshme padinë e tyre.

Më 14 tetor 2011 (data e vulës postare; regjistruar më 17 tetor 2011), Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut (AKM) parashtroi përgjigje në Dhomën e Posaçme. AKM-ja kërkoi nga Kolegji i Apelit që ta refuzojë ankesën pasi që i mungonte baza ligjore dhe ta vërtetojë aktgjykimin e ankimuar të Trupit Gjykues. AKM-ja paraqiti se ankuesit nuk arritën ta bëjnë dallimin në mes të fakteve të vërtetuara nga Trupi Gjykues dhe vlerësimin e atyre fakteve për zbatimin e të drejtës materiale. Sipas AKM-së ankuesit me të drejtë pohuan se Trupi Gjykues vërtetoi se atyre u ishte mohuar prona e tyre në mënyrë të paligjshme. Megjithatë, Trupi Gjykues e shpjegoi qartë se ankuesit mundeshin ose kishin të drejtë që të kërkonin kthimin e një prone që pretendohej të ishte konfiskuar në mënyrë të paligjshme; ajo e drejtë ishte zvogëluar në rrethanat e tanishme me fitimin e të drejtave pronësore për mu këtë pronë tani nga e paditura 2, përmes parashkrimit fitues. Prandaj, pretendimeve të ankuesve se Trupi Gjykues nuk e përmbushi neni 8.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) u mungon baza ligjore. Më tej, në këtë rast janë përmbushur të dyja kushtet e parapara me nenin 28.4 të LMTHP-së dhe Trupi Gjykues me të drejtë i vërtetoi faktet e lëndës në bazë të provave të dorëzuara nga AKM-ja. AKM-ja iu referua edhe aktgjykimeve të mëparshme të lëshuara nga Dhoma e Posaçme lidhur me fitimin e të drejtave pronësore të pronave shoqërore në Kosovë, *Komuna e Prizrenit kundër AKM-së, Komuna e Pejës kundër AKM-së dhe SHA "T" Pejë kundër kompanisë hoteliere turistike "R"* (*Rastet e rrëmbimit të tokave komunale*). Sa i përket "mirëbesimit" të NSH-së M lidhur me posedimin e "H.K" AKM-ja paraqet se duhet të bëhet dallimi në mes të "Shtetit" dhe NSH-së M. NSH.M nuk është subjekt shtetëror apo organ vartës i Shtetit apo i komunës. Përkundrazi, ajo është ndërmarrje e pavarur dhe vet-menaxhuese. AKM-ja pohoi se edhe po të kishte ndonjë indikacion të qartë të keqbesimit nga ana e institucionit shtetëror lidhur me konfiskimin e pronës, konstatimi i keqbesimit të tillë do të ishte i parëndësishëm dhe pa pasoja lidhur me posedimin në mirëbesim të pronës nga NSH-ja.

Më 13 gusht 2012, ankuesit e dorëzuan përgjigjen e tyre në përgjigjen e AKM-së ndaj ankesës së ankuesve. Ata pohojnë se nuk është përmbushur kushti i dytë i paraparë me nenin 28.4 të LMTHP-së pasi që prona nuk është mbajtur në "mirëbesim". Komuna e Pejës nuk e ka shpronësuar pronën kontestuese por e ka konfiskuar atë dhe si e tillë ajo nuk ishte poseduese në *mirëbesim*. Lëndët të cilave ju është referuar AKM-ja në përgjigjen e saj kanë të bëjnë me konteste në mes të dy subjekteve ligjore e jo siç është në rastin në fjalë ku kontesti është në mesë të personave privat dhe subjektit shoqëror. Pasi që Komuna nuk e ka poseduar në mirëbesim atëherë askush pas saj nuk mund ta kishte në mirëbesim. Për më tepër, ata pohuan se ligji sipas të cilit u konfiskua prona e tyre nuk ishte i vlefshëm qysh para se të lëshohej vendimi për konfiskim.

Më 8 tetor 2012, AKM-ja parashtroi kundërpërgjigje.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

Aktgjykimi i ankimuar ishte lëshuar më 10 dhjetor 2009. Më 12 janar 2010 iu dërgua përfaqësuesit të ankuesve dhe AKP-së. Ankesa e paditësve u parashtrua më 10 shkurt 2010.

Ankesa është e pranueshme pasi që është parashtruar brenda afatit si dhe nga personi i autorizuar.

Meritat e ankesës

Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej: LDHP), Kolegji i Apelit vendosi që të mos e mbajë pjesën gojore të procedurës.

Në lëndën në fjalë është vendimtare çështja nëse aktvendimi për konfiskim K.K. Br. 18/45 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i datës 29 dhjetor 1945, u shkaktoi paraardhësve të paditësve humbjen e pronësisë së pasurisë së patundshme "H.K" në Pejë.

Kolegji i Apelit konstaton se ky aktvendimi (sipas kopjes së origjinalit të dokumentit që është mbajtur nga Zyrtari Administrativ për marrëdhënie pronësore i Gjykatës së Qarkut në Pejë) i cili ishte marrë më 29 dhjetor 1945 dhe që ishte shpallur detyrues dhe i formës së prerë më 16 nëntor 1955 nga Gjykata e Qarkut në Pejë duhet të respektohet nga të gjithë duke i përfshirë edhe gjykatat pavarësisht nëse konstatimi i fakteve apo vlerësimi ligjor që çoi në vendosje ishte i mangët. Vendimi në fjalë nuk ka të meta aq të ashpra sa këto mangësi do ta bënin atë të pavlefshëm *prima facie*. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat e shqyrtimit në gjykata të rregullta të kenë qenë të padrejta apo të njollosura nga arbitrariteti (Vendimi në rastin nr. KL 14/09 i datës 15 tetor 2010). Sa i përket çështjes së kthimit të pronës, Kolegji i Apelit ka të njëjtin mendim sikurse Gjykata Kushtetuese e cila në Vendimin e saj të datës 15 tetor 2010 theksoi se Kuvendi i Kosovës e ka atë detyrë që çështjet e tilla t'i zgjidh përmes Ligjit për Kthimin e Pronave.

Në mungesë të ndonjë baze ligjore për të vënë në diskutim çështjen e vlefshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të datës 29 dhjetor 1945, nuk ka dyshime ligjore se paraardhësit e paditësve kishin humbur të drejtat e tyre pronësore mbi "H.K" dhe as ata e as ankuesit nuk i kthyen më ato të drejta. Duke marrë parasysh padinë pronësore të paditësve, kjo çështje me të drejtë është refuzuar nga Trupi Gjykues.

Prandaj, në bazë të nenit 10 paragrafi 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (çështjet e privatizimit) , ankesa e ankuesve duhet të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i ankimuar duhet të vërtetohet.

Lidhur me pikën 3 të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, Kolegji i Apelit vërteton se paditësve duhet t'iu kompensohet menjëherë shuma prej 20000 Euro.

Taksat/shpenzimet gjyqësore:

Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27 mars 2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive në lëndët në pritje.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, 2 shtator 2016

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues